



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 53

Tiranë – E enjte, 12 mars 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 4, datë 4.3.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar.....	3911
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 243, datë 6.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës	3916
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 244, datë 6.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	3917
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 245, datë 6.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës.....	3918
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 246, datë 6.3.2026	Për anulimin e urdhrit të delegimit të kompetencës.....	3919
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 247, datë 6.3.2026	Për delegim kompetence.....	3920
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 251, datë 9.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	3920
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 252, datë 9.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës.....	3922

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 253, datë 9.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë.....	3923
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 254, datë 9.3.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës	3925
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 227, datë 6.3.2026	Për delegim kompetence.....	3926
Urdhër i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit nr. 74, datë 9.3.2026	Për delegim kompetence.....	3926
	Autorizim i ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit.....	3927
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 12.2.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4363 (271), datë 27.6.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.....	3927



UDHËZIM
Nr. 4, datë 4.3.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 759, DATË 30.9.2024,
“PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE
VEPRIMTARISË, MENAXHIMIN E
BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJES SË
NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË
INSTITUCIONEVE, OFRUESVE TË
ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË
VAZHDUAR PROFESIONAL TË
PERSONELIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 4, të nenit 12, dhe të pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 15, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 759, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në kreun XVII, neni 76, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në pikën 1, pas shkronjës “q” shtohet shkronja “r” me përmbajtje si më poshtë:

“r) identifikon nxënësit me rrezik braktisjeje në kuadër të sistemit të paralajmërimit të hershëm, me qëllim marrjen e masave mbështetëse për parandalimin e braktisjes dhe riintegrimin e nxënësve në sistemin arsimor”;

b) Në pikën 2, pas numrit “xiv”, shtohet numri “xv” me përmbajtje si më poshtë:

“xv. identifikon nxënësit me rrezik braktisjeje në kuadër të sistemit të paralajmërimit të hershëm, me qëllim marrjen e masave mbështetëse për parandalimin e braktisjes dhe riintegrimin e nxënësve në sistemin arsimor”.

2. Në kreun XVIII, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Në nenin 78, pas pikës 1, shkronja “d” shtohen shkronjat “e”, “f” dhe “g”, me përmbajtje si më poshtë:

“e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;

g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.”;

b) Pas nenit 78 shtohet neni 78/1, me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 78/1

**Kriteret e marrjes në punë të
zëvendës drejtorit të AFP-së**

Kandidati aplikues për zëvendës drejtor të ofruesit publik të AFP-së duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë:

1. Kriteret të përgjithshme:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;

e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;

g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteret të posaçme për zëvendës drejtorin, që mbulon kulturën e përgjithshme:

a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Bachelor” dhe “Master i shkencave” (ose të barasvlershme) në fushën e mësuesisë;

b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;

c) të jetë vlerësuar të paktën “Mirë” në provimin e kualifikimit;

d) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

e) preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të huaja të tjera.

3. Kriteret të posaçme për zëvendës drejtorin, që mbulon kulturën profesionale:



a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Bachelor” dhe “Master shkencor” (ose të barasvlershme) në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;

b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;

c) të jetë vlerësuar të paktën “Mirë” në provimin e kualifikimit;

d) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit;

e) preferohet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të huaja të tjera.”;

c) Nenet 79 dhe 80 shfuqizohen;

d) Në nenin 81 bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. titulli “Shpallja për vend të lirë për drejtor të ofruesit publik të AFP-së” zëvendësohet me titullin “Shpallja për vend të lirë për drejtor/ zëvendës-drejtor të ofruesit publik të AFP-së”;

ii. pika 1 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“1. AKPA-ja shpall vendin e lirë për drejtor/zëvendës-drejtor në ofruesin publik të AFP-së, pasi vendi i drejtorit/zëvendës-drejtorit mbetet vakant.”;

e) Në nenin 83 bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. pika 1 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“1. Komisioni i vlerësimit për drejtorin ngrihet në Drejtorinë Qendrore të AKPA-së dhe përbëhet nga 3 (tre anëtarë):

a) Drejtori i drejtorisë që mbulon çështjet e burimeve njerëzore në Drejtorinë Qendrore të AKPA-së (anëtar i komisionit);

b) Drejtori i drejtorisë që mbulon çështjet e arsimit dhe formimit profesional, në Drejtorinë Qendrore të AKPA-së (anëtar i komisionit);

c) Kryetari i bordit drejtues të ofruesit publik të AFP-së, ose një anëtar i autorizuar prej tij (anëtar i komisionit).”;

ii. pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si më poshtë:

“1/1. Komisioni i vlerësimit për nëndrejtorin ngrihet në Drejtorinë Qendrore të AKPA-së dhe përbëhet nga 3 (tre anëtarë):

a) Drejtori i drejtorisë që mbulon çështjet e burimeve njerëzore në Drejtorinë Qendrore të AKPA-së (anëtar i komisionit);

b) Drejtori i drejtorisë që mbulon çështjet e arsimit dhe formimit profesional, në Drejtorinë Qendrore të AKPA-së (anëtar i komisionit);

c) Drejtori i ofruesit publik të AFP-së, që ka vendin vakant (anëtar i komisionit).”;

f. Pas nenit 84 shtohet neni 84/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 84/1

Procesi i përzgjedhjes së zëvendës-drejtorit

Procesi i përzgjedhjes së zëvendës-drejtorit të ofruesit publik të AFP-së, kalon në këto faza:

1. Faza e parë:

a) njësia e burimeve njerëzore pranë AKPA-së verifikon paraprakisht dokumentacionin e dorëzuar nga çdo aplikant dhe miraton listën paraprake të kandidatëve të kualifikuar për në fazën e dytë, me dokumentacion të plotë, në përputhje me kërkesat e aplikimit;

b) kandidatët që nuk janë kualifikuar, njoftohen nga njësia e burimeve njerëzore pranë AKPA-së, në adresën e tyre të *email*-it, duke sqaruar dhe arsyet e moskualifikimit;

c) brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e njoftimit, kandidatët që nuk janë kualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Drejtorisë Qendrore të AKPA-së. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të saj dhe, nëse i rijepet e drejta e kualifikimit, kalon në fazën e dytë;

d) pas përfundimit të afateve të ankimimit, lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar, sipas rendit alfabetik, shpallet në faqen zyrtare të AKPA-së, si dhe në një vend të dukshëm të ofruesit publik të AFP-së, për të cilin zhvillohet konkurrimi.

2. Faza e dytë:

Në këtë fazë struktura e vlerësimit të kandidatëve është si më poshtë:

a) vlerësimi për dokumentacionin e dorëzuar është 40 pikë i ndarë si vijon:

Arsimimi dhe kualifikimet	15 pikë;
Përvoja në punë	15 pikë;
Niveli i njohurive në përdorimin e teknologjisë së informacionit	5 pikë;
Niveli i njohurive në gjuhë të huaj	5 pikë;

b) vlerësimi për kriteret e tjera nëpërmjet intervistës me gojë është 60 pikë;

c) komisioni për intervistën e strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh të bazuara në kompetenca, për të gjithë kandidatët;

d) në intervistë, ndër të tjera, kandidati vlerësohet për:



i. njohuritë e përgjithshme mbi legjislacionin, mbi të cilin rregullohet dhe organizohet veprimtaria e ofruesit publik të AFP-së;

ii. perspektivën e tij për planifikimin, organizimin dhe ndjekjen e zhvillimit të procesit mësimor në ofruesit publik të AFP-së;

e) komisioni mbledh pikët dhe liston kandidatët sipas pikëve. Në rastet kur ka më shumë se dy kandidatë me numër të njëjtë pikësh, ka prioritet kandidati që ka më shumë pikë në intervistën me gojë;

f) minimumi i pikëve për t'u kualifikuar është 70 pikë;

g) nëse asnjëri nga kandidatët nuk merr në total të paktën 70 pikë, komisioni vendos përfundimin e fazës së vlerësimit pa asnjë kandidat fitues;

h) vendimi përfundimtar i komisionit i njoftohet zyrtarisht drejtorit të përgjithshëm të AKPA-së, së bashku me listën e kandidatëve të renditur sipas pikëve;

i) Drejtoria Qendrore e AKPA-së njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre, brenda 1 (një) dite pune nga data e marrjes dijeni të vendimit të komisionit;

j) kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, për rezultatin e pikëve pranë Drejtorisë Qendrore të AKPA-së, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e marrjes së rezultateve të vlerësimit;

k) komisioni i vlerësimit shqyrton ankesat brenda dy ditëve nga data e njoftimit të marrë nga njësia e burimeve njerëzore;

l) ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës;

m) në përfundim të procesit të për zgjedhjes, komisioni i vlerësimit i paraqet drejtorit të përgjithshëm të AKPA-s një raport përmbledhës mbi procesin e vlerësimit në përgjithësi;

n) në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues, AKPA-ja rishpall procedurën brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.”;

g) Pas nenit 85, shtohet neni 85/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 85/1

Emërimi i kandidatit për zëvendës drejtor

1. Pas shqyrtimit dhe miratimit nga drejtori i përgjithshëm i AKPA-së, të raportit përmbledhës të komisionit të vlerësimit, drejtori i ofruesit publik të AFP-së, emëron kandidatin e renditur i pari.

2. Njoftimi për emërimin bëhet në faqen zyrtare të AKPA-së, në faqen elektronike zyrtare të ofruesit publik të AFP-së, nëse ka, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të institucionit, që ka vendin e lirë.”;

h) Në nenin 86 bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. titulli i nenit “Mbarimi i marrëdhënies së punës së drejtorit të ofruesit publik të AFP-së” zëvendësohet me titullin “Mbarimi i marrëdhënies së punës dhe ulja në detyrë e drejtorit të ofruesit publik të AFP-së”;

ii. pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

“2/1. Drejtori i ofruesit publik të AFP-së, me paraqitjen e kërkesës për dorëheqje ka të drejtë të paraqesë edhe kërkesën për t'u ulur në detyrë në pozicione vakante të ofruesit publik të AFP-së, nëse plotëson kriteret e përcaktuara dhe kërkesa miratohet nga ministri përgjegjës për AFP-në”;

iii. pika 7 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“7. Lirimi, largimi nga detyra ose ulja në detyrë e drejtorit të ofruesit publik të AFP-së bëhet nga ministri përgjegjës për AFP-në”;

i. pas nenit 86, shtohet neni 86/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 86/1

Mbarimi i marrëdhënies së punës dhe ulja në detyrë e zëvendës drejtorit të ofruesit publik të AFP-së

1. Mbarimi i marrëdhënies së punës së zëvendës drejtorit të ofruesit publik të AFP-së, bëhet kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit;

c) bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për arsye shëndetësore;

d) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës;

e) merret masa disiplinore e largimit nga puna.

2. Në rastin kur bie numri i nxënësve të regjistruar, mbi të cilin bazohet përcaktimi i numrit të zëvendës drejtorëve në një ofrues publik të arsimit profesional bëhet rivlerësimi i dosjeve të të gjithë zëvendës drejtorëve. Drejtori i ofruesit publik të AFP-së ngre komisionin përkatës, sipas përcaktimeve të nenit 83 të këtij udhëzimi. Procedurat e vlerësimit bëhen sipas përcaktimeve të nenit 84/1 të këtij udhëzimi.



3. Zëvendësdyrektoret kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për t'u ulur në detyrë në pozicionin e mësimdhënësit. Nëse janë mësimdhënës të kulturës së përgjithshme, procedura e pikëzimit bëhet sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit parauniversitar. Nëse janë mësimdhënës të kulturës profesionale, procedura e pikëzimit bëhet sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

4. Drejtori i ofruesit publik të AFP-së merr masën disiplinore të largimit nga puna, kur zëvendësdyrektori:

- a) shkel dispozitat e Kodit të Punës, legjislacionit të AFP-së dhe legjislacionit për sistemin e arsimit parauniversitar;
- b) shkel etikën dhe sjelljen në punë;
- c) ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit;
- d) ka falsifikuar dokumente zyrtare;
- e) ka nxitur vartësit e tij të falsifikojnë dokumente zyrtare;
- f) ka ushtruar dhunë fizike ose psikologjike ndaj nxënësve/kursantëve ose personelit mbështetës të ofruesit publik të AFP-së;
- g) ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të ofruesit publik të AFP-së;
- h) ka marrë ose dhënë rryshfet;
- i) ka dhënë kopje ose ka organizuar kopje në provimet kombëtare dhe ato që zhvillohen në nivel ofruesi publik, ose ka kryer shkelje të procedurave të zhvillimit të provimeve kombëtare apo të provimeve në nivel ofruesi publik, në shkelje të procedurave dhe ndonjë rregullimi të brendshëm;
- j) ka organizuar pjesëmarrjen e mësuesve ose nxënësve në veprimtari politike.

5. Zëvendësdyrektori ka të drejtë të dëgjohet nga drejtori i ofruesit publik të AFP-së, përpara se ky i fundit të vendosë për largimin e tij.

6. Lirimi, largimi nga detyra ose ulja në detyrë e zëvendësdyrektorit bëhet nga drejtori i ofruesit publik të AFP-së.”;

j) Neni 88, ndryshon me përmbajtje, si më poshtë:

“Neni 88

Kriteret e marrjes në punë të përgjegjësit të bazës prodhuese në ofruesit publik të AFP-së

Kandidati aplikues për përgjegjës të bazës prodhuese të ofruesit publik të AFP-së duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë:

1. Kriteret e përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të organizimit dhe planifikimit strategjik, aftësi analitike për zgjidhjen e problemeve;
- g) të demonstrojë aftësi drejtuese, të punës në grup dhe motivimit.

2. Kriteret e posaçme për përgjegjësin e bazës prodhuese:

- a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master shkencor” (ose të barasvlershme) në një nga fushat që lidhet me kualifikimet profesionale të ofruesit publik të AFP-së;
- b) të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;
- c) të ketë njohuri të certifikuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit;
- d) të ketë përvojë pune të paktën 5 vjet në fushën që lidhet me kualifikimet profesionale të njërit prej drejtimeve mësimore të ofruesit publik të AFP-së.”;
- k) Në nenin 89 bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - i. kudo në titull dhe në nen fjala “zëvendësdyrektor” hiqet;
 - ii. pika 7 shfuqizohet;
 - l) Në nenet 90, 92, 93, 94, 95 kudo në titull dhe në nen, fjala “zëvendësdyrektor” hiqet;
 - m) Neni 95, ndryshon me përmbajtje, si më poshtë:



“Neni 95

**Mbarimi i marrëdhënies së punës së
përgjegjës të bazës prodhuese të ofruesit
publik të AFP-së**

1. Mbarimi i marrëdhënies së punës së përgjegjës të bazës prodhuese të ofruesit publik të AFP-së bëhet kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) bëhet i paaftë për kryerjen e detyrave për arsye shëndetësore;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- e) merret masa disiplinore e largimit nga puna.

2. Drejtori i ofruesit publik të AFP-së merr masën disiplinore të largimit nga puna, kur përgjegjësi i bazës prodhuese:

- a) shkel dispozitat e Kodit të Punës, legjislacionit të AFP-së dhe legjislacionit për sistemin e arsimor parauniversitar;
- b) shkel etikën dhe sjelljen në punë;
- c) ka bërë deklaratë të rreme në procesin e aplikimit;
- d) ka falsifikuar dokumente zyrtare;
- e) ka nxitur vartësit e tij të falsifikojnë dokumente zyrtare;

f) ka ushtruar dhunë fizike ose psikologjike ndaj nxënësve/kursantëve ose personelit mbështetës të ofruesit publik të AFP-së;

g) ka përvetësuar fonde financiare ose materiale të ofruesit publik të AFP-së;

h) ka marrë ose dhënë rryshfet.

3. Përgjegjësi i bazës prodhuese ka të drejtë të dëgjohet nga drejtori i ofruesit publik të AFP-së, përpara se ky i fundit të vendosë për largimin e tij.

4. Lirimi dhe largimi nga detyra i përgjegjës të bazës prodhuese bëhet nga drejtori i ofruesit publik të AFP-së.”.

3. Në kreun XX, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) Në nenin 100 bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. titulli “Detyrat e përgjegjës të njësisë së zhvillimit” zëvendësohet me titullin “Detyrat e përgjegjës të njësisë së zhvillimit”;

ii. në pikën 2, pas shkronjës “m” shtohet shkronja “n” me përmbajtje si më poshtë:

“n) identifikon nxënësit me rrezik braktisjeje, në kuadër të sistemit të paralajmërimit të hershëm, me qëllim marrjen e masave mbështetëse për

parandalimin e braktisjes dhe riintegrimin e nxënësve në sistemin arsimor”;

b) Në nenin 103, pas shkronjës “o” shtohet shkronja “p” me përmbajtje si më poshtë:

“p) bashkëpunon me zyrën e punës për identifikimin e bizneseve që kanë vende të lira për praktika profesionale dhe për zbatimin e kontratës për mësimin e profesionit”;

c) Në nenin 104, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “h” me përmbajtje si më poshtë:

“h) identifikon nxënësit me rrezik braktisjeje, në kuadër të sistemit të paralajmërimit të hershëm, me qëllim marrjen e masave mbështetëse për parandalimin e braktisjes dhe riintegrimin e nxënësve në sistemin arsimor”;

d) Në nenin 106, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “e” me përmbajtje si më poshtë:

“e) identifikon nxënësit me rrezik braktisjeje, në kuadër të sistemit të paralajmërimit të hershëm, me qëllim marrjen e masave mbështetëse për parandalimin e braktisjes dhe riintegrimin e nxënësve në sistemin arsimor”;

e) Në nenin 107, pas shkronjës “g” shtohet pika “h” me përmbajtje si më poshtë:

“h) bashkëpunon me zyrat e punës, bizneset partnere dhe institucionet vendore, për të koordinuar punësimin e të certifikuarve/ diplomuarve, duke synuar rritjen e punësueshmërisë dhe përfshirjes së tyre në tregun e punës”;

f) Në nenin 108, bëhen ndryshimet si më poshtë:

i. titulli i nenit “Kriteret e caktimit të anëtarëve të njësisë së zhvillimit” zëvendësohet me titullin “Kriteret e caktimit të përgjegjës të anëtarëve të njësisë së zhvillimit”;

ii. pika 1 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“1. Anëtarët e njësisë së zhvillimit janë përfaqësues të personelit me kohë të plotë të ofruesit publik të AFP-së”;

iii. fjalia e parë, e pikës 2 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“2. Caktimi i përgjegjës të anëtarëve të njësisë së zhvillimit në institucionet e arsimit profesional bazohet në këto kriteret:”;

iv. shkronja “f” ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“f) Përgjegjësi, përveç kriterëve të mësipërme duhet të ketë të paktën diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master shkencor” (ose të barasvlershme) dhe titullin “Mësues i kualifikuar”.”;



g) Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me përmbajtje si më poshtë:

“g) çdo anëtar i njësisë së zhvillimit në ofruesit publikë të arsimit profesional përveç kriterëve të mësipërme, duhet të ketë të paktën diplomë të studimeve universitare të nivelit “Master profesional” (ose të barasvlershme) dhe titullin “Mësues i kualifikuar.”;

h) Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:

“3. Anëtarët e njësisë së zhvillimit në qendrat e formimit profesional do të jenë specialistët e sektorit të administrimit të formimit profesional”.

4. Në kreun XXI, në nenin 115, pika 3, pas shkronjës “i” shtohet shkronja “j” me përmbajtje si më poshtë:

“j) identifikon nxënësit me rrezik braktisjeje, në kuadër të sistemit të paralajmërimit të hershëm, me qëllim marrjen e masave mbështetëse për parandalimin e braktisjes dhe riintegrimin e nxënësve në sistemin arsimor”.

5. Në kreun XXII bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) Në nenin 119, pika 8 shfuqizohet;

b) Në nenin 123, pika 2, shkronja “g”, togfjalëshi “sipas nenit 107”, zëvendësohet me togfjalëshin “sipas nenit 118”.

6. Në kreun XXIV, në nenin 136, pika 8 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

a) “8. Kriteret e posaçme për sekretar shkolle, magazinier, punonjës ndihmës:

a) të ketë nivelin arsimor të mesëm ose shkollë të mesme profesionale, në fushën në shpalljen për pozicionin përkatës;

b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës.”;

b) Në nenin 136, pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me përmbajtjen si më poshtë:

“8/1. Kriteret e posaçme për punonjës pastrimi, punonjës i sigurisë (roje):

a) të kenë nivelin arsimor bazë.”.

7. Kudo në udhëzim, togfjalëshi “Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit” bëhet “Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit”.

8. Kudo në udhëzim, togfjalëshi “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional” bëhet “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë, menaxhimin e burimeve njerëzore, zhvillimin e vazhduar profesional të personelit, përbërjen e

njësisë së zhvillimit, të institucioneve ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOACIONIT
Delina Ibrahimaj

URDHËR Nr. 243, datë 6.3.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E DANIMARKËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Veterinary Inspection Unit South	Fredericia*
2.	Veterinary Inspection Unit East	Slagelse*
3.	Veterinary Inspection Unit East	Assens*
4.	Veterinary Inspection Unit East	Lolland*
5.	Veterinary Inspection Unit North	Viborg*
6.	Veterinary Inspection Unit North	Mariagerfjord*
7.	Veterinary Inspection Unit North	Lemvig*
8.	Veterinary Inspection Unit East	Helsingør*
9.	Veterinary Inspection Unit East	Guldborgsund*
10.	Veterinary Inspection Unit East	Holbæk*



11.	Veterinary Inspection Unit East	Næstved*
12.	Veterinary Inspection Unit East	Nyborg*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 189, datë 23.2.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 244, datë 6.3.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70 °C në 3.6 sekonda;

iii. 74 °C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Bayern	Erding	Steinkirchen*
2.	Brandenburg	Oder-Spre	Neuzelle*



3.	Bayern	Erding	Bockhorn*
4.	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Bestensee*
5.	Bayern	Mühldorf am Inn	Neumarkt-Sankt Veit*
6.	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Königs Wusterhausen*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Gjermanisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 239, datë 5.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR Nr. 245, datë 6.3.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HOLANDËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Drenthe	Aa en Hunze*
2.	Gelderland	Barnveld*
3.	Gelderland	Kesteren*
4.	Gelderland	Hummelo en Keppel*
5.	Flevoland	Noordoostpolder*
6.	Friesland	Achtkarspelen*
7.	Gelderland	Ede*
8.	Flevoland	Dronten*
9.	Noord-Holland	Beverwijk*
10.	Groningen	Delfzijl*
11.	Zuid-Holland	Dordrecht*
12.	Zeeland	Hulst*



13.	Limburg	Meerlo-Wanssum*
14.	Limburg	Helden*
15.	Overijssel	Wierden*
16.	Flevoland	Zeewolde*
17.	Gelderland	Nijkerk*
18.	Gelderland	Harderwijk*
19.	Drenthe	Coevorden*
20.	Gelderland	Ermelo*
21.	Noord-Brabant	Woudrichem*
22.	Limburg	Venray*
23.	Noord-Brabant	Deurne*
24.	Noord-Brabant	Oisterwijk*
25.	Zuid-Holland	Maasland*
26.	Gelderland	Buren*
27.	Overijssel	Almelo*
28.	Groningen	Stadskanaal*
29.	Friesland	Dongeradeel*
30.	Groningen	Eemsmont*
31.	Utrecht	Renswoude*
32.	Gelderland	Neede*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 240, datë 5.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i

Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 246, datë 6.3.2026

PËR ANULIMIN E URDHËRIT TË DELEGIMIT TË KOMPETENCËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si edhe të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Anullohet urdhri nr. 129, datë 9.2.2026, “Për delegim kompetence”, me nr. 1237 prot., datë 9.2.2026, i cili parashikonte delegimin e të drejtës së firmës zëvendësministrit z. Fatmir Guri, për procedurat e importeve për datat 9.2.2026 deri më datë 9.4.2026.

2. Anulimi hyn në fuqi menjëherë.

3. Pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri, të gjitha kompetencat e parashikuara në urdhrin e anuluar kthehen në ushtrim ekskluziv të ministrit, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative, si dhe të gjitha strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv/protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



URDHËR

Nr. 247, datë 6.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Për shkak të angazhimeve për të garantuar vijimësinë e veprimtarisë administrative të Ministrisë, delegoj të drejtën e firmës për të gjitha dokumentet dhe aktet që lidhen me procedurat e importeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit z. Arian Jaupllari, për periudhën 9 dhe 10 mars 2026.

2. Zëvendësministri i përmendur në pikën 1 është i autorizuar të nënshkruajë në emër të ministrit dokumentet që lidhen me importet, si më poshtë:

- Kërkesat dhe miratimet për importe sipas kompetencës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Autorizimet, vërtetimet dhe shkresat zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore dhe subjekteve private për çështje që lidhen me importet;

- Çdo dokument tjetër administrativ që kërkon firmën e ministrit në fushën e importeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ky delegim është i vlefshëm vetëm për periudhën 9 dhe 10 mars 2026. Pas kësaj date, e drejta e firmës kthehet tek ministri sipas kompetencave të tij të plota ligjore.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative, drejtoria përgjegjëse për importet dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv/protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 251, datë 9.3.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Dolnośląskie	Bolesławiec	Bolesławiec (rural)*
Dolnośląskie	Dzierżoniów	Pieszyce*
Dolnośląskie	Dzierżoniów	Niemcza*
Dolnośląskie	Góra	Jemielno*
Dolnośląskie	Jawor	Mściwojów*
Dolnośląskie	Jelenia Góra	Jeźów Sudecki*
Dolnośląskie	Jelenia Góra	Podgórzyn*
Dolnośląskie	Legnica	Chojnów (rural)*
Dolnośląskie	Kamienna Góra	Kamienna Góra (rural)*
Dolnośląskie	Kamienna Góra	Lubawka*
Dolnośląskie	Kamienna Góra	Marciszów*
Dolnośląskie	Kłodzko	Bystrzyca Kłodzka*
Dolnośląskie	Lubań	Leśna*
Dolnośląskie	Lubań	Siekierczyn*
Dolnośląskie	Lwówek Śląski	Lwówek Śląski*
Dolnośląskie	Lwówek Śląski	Wleń*
Dolnośląskie	Kłodzko	Stronie Śląskie*
Dolnośląskie	Kłodzko	Radków*
Dolnośląskie	Oława	Jelcz-Laskowice*
Dolnośląskie	Środa Śląska	Kostomłoty*
Dolnośląskie	Środa Śląska	Malczyce*
Dolnośląskie	Świdnica	Jaworzyna Śląska*
Dolnośląskie	Świdnica	Marcinowice*
Dolnośląskie	Złotoryja	Pielgrzymka*
Dolnośląskie	Złotoryja	Świerzawa*
Dolnośląskie	Lubiń	Lubin (rural)*



Dolnośląskie	Lubiń	Ścinawa*
Dolnośląskie	Walbrzych	Gluszyca*
Dolnośląskie	Wolów	Wińsko*
Dolnośląskie	Ząbkowice Śląskie	Kamieniec Ząbkowicki*
Dolnośląskie	Ząbkowice Śląskie	Ziębice*
Dolnośląskie	Zgorzelec	Sulików*
Dolnośląskie	Zgorzelec	Węgliniec*
Opolskie	Brzeg	Lewin Brzeski*
Opolskie	Brzeg	Skarbimierz*
Opolskie	Kędzierzyn-Koźle	Polska Cerekiew*
Opolskie	Opole	Niemodlin*
Pomorskie	Człuchów	Debrzno*
Pomorskie	Słupsk	Damnica*
Warmińsko-Mazurskie	Gołdap	Banie Mazurskie*
Warmińsko-Mazurskie	Gołdap	Gołdap*
Warmińsko-Mazurskie	Lidzbark	Orneta*
Warmińsko-Mazurskie	Olecko	Kowale Oleckie*
Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jeziorany*
Wielkopolskie	Czarnków-Trzcianka	Krzyż Wielkopolski*
Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
Wielkopolskie	Kościan	Śmigiel*
Wielkopolskie	Konin	Kazimierz Biskupi*
Wielkopolskie	Międzybóże	Kwilcz*
Wielkopolskie	Piła	Kaczory*
Wielkopolskie	Poznań	Czerwonak*
Wielkopolskie	Złotów	Zakrzewo*
Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
Zachodniopomorskie	Drawsko	Czaplinek*
Zachodniopomorskie	Drawsko	Ostrowiec*
Zachodniopomorskie	Gryfino	Stare Czarnowo*
Zachodniopomorskie	Goleniów	Osina*
Zachodniopomorskie	Kołobrzeg	Dygowo*
Zachodniopomorskie	Kołobrzeg	Kołobrzeg (rural)*
Zachodniopomorskie	Pyrzyce	Lipiany*
Zachodniopomorskie	Pyrzyce	Pyrzyce*
Zachodniopomorskie	Ślawn	Darłowo (rural)*
Zachodniopomorskie	Stargard	Suchań*
Zachodniopomorskie	Świdwin	Polczyn-Zdrój*
Zachodniopomorskie	Świdwin	Świdwin (rural)*
Zachodniopomorskie	Szczecin	Szczecin*
Zachodniopomorskie	Szczecinek	Barwice*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose



iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antittrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 110, datë 4.2.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 252, datë 9.3.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;



- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Drenthe	Aa en Hunze*
2.	Gelderland	Barneveld*
3.	Gelderland	Kesteren*
4.	Gelderland	Hummelo en Keppel*
5.	Flevoland	Noordoostpolder*
6.	Friesland	Achtkarspelen*
7.	Gelderland	Ede*
8.	Flevoland	Dronten*
9.	Noord-Holland	Beverwijk*
10.	Groningen	Delfzijl*
11.	Zuid-Holland	Dordrecht*
12.	Zeeland	Hulst*
13.	Limburg	Meerlo-Wanssum*
14.	Limburg	Helden*
15.	Overijssel	Wierden*
16.	Flevoland	Zeewolde*
17.	Gelderland	Nijkerk*
18.	Gelderland	Harderwijk*
19.	Drenthe	Coevorden*
20.	Gelderland	Ermelo*
21.	Noord-Brabant	Woudrichem*
22.	Limburg	Venray*
23.	Noord-Brabant	Deurne*
24.	Noord-Brabant	Oisterwijk*
25.	Zuid-Holland	Maasland*
26.	Gelderland	Buren*
27.	Overijssel	Almelo*
28.	Groningen	Stadskanaal*
29.	Friesland	Dongeradeel*
30.	Groningen	Eemsmond*
31.	Utrecht	Renswoude*
32.	Gelderland	Neede*
33.	Gelderland	Putten*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 245, datë 6.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari

URDHËR
Nr. 253, datë 9.3.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GJERMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:



a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70 °C në 3.6 sekonda;

iii. 74 °C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Bayern	Erding	Steinkirchen*
2	Brandenburg	Oder-Spree	Neuzelle*
3	Bayern	Erding	Bockhorn*
4	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Bestensee*
5	Bayern	Mühlendorf am Inn	Neumarkt-Sankt Veit*
6	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Königs Wusterhausen*
7	Bayern	Rottal-Inn	Gangkofen*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Gjermanisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikatë veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 244, datë 6.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari



URDHËR
Nr. 254, datë 9.3.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E DANIMARKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Veterinary Inspection Unit South	Fredericia*
2.	Veterinary Inspection Unit East	Slagelse*
3.	Veterinary Inspection Unit East	Assens*
4.	Veterinary Inspection Unit East	Lolland*
5.	Veterinary Inspection Unit North	Viborg*
6.	Veterinary Inspection Unit North	Mariagerfjord*
7.	Veterinary Inspection Unit North	Lemvig*
8.	Veterinary Inspection Unit East	Helsingør*
9.	Veterinary Inspection Unit East	Guldborgsund*
10.	Veterinary Inspection Unit East	Holbæk*
11.	Veterinary Inspection Unit East	Næstved*

12.	Veterinary Inspection Unit East	Nyborg*
13.	Veterinary Inspection Unit East	Nordfyns*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 243, datë 6.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari



URDHËR
Nr. 227, datë 6.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të gërmës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; germa “c”, e pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave z. Gentjan Mahmutaj, Koordinator për të Drejtën e Informimit në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, për sa vijon:

- Për të nënshkruar kthim përgjigje, me karakter njohës dhe informues, dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, në lidhje me kërkesat për informacion drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, në zbatim të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, që u drejtohen të tretëve (personat fizikë, personat juridike privat), si dhe ato të drejtuar strukturave të varësisë së ASHK-së në funksion të informimit të të tretëve.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, Koordinatori për të Drejtën e Informimit nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurës Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data e miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet z. Gentjan Mahmutaj dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli

URDHËR
Nr. 74, datë 9.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; të nenit 11 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 12.2.2024, të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për nënshkrimin e dokumentacionit të klasifikuar, nga data 9.3.2026 deri në plotësimin e detyrimeve ligjore për njohjen me informacionin e klasifikuar, tek anëtari i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, z. Altin Hoxha.

2. Ngarkohet anëtari i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, z. Altin Hoxha, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Gentiana Sula

**AUTORIZIM****Nr. 2006, datë 4.3.2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, i ndryshuar; si dhe në zbatim të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar; të kreut III, të vendimit nr. 832, datë 3.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, të ndryshuar; të vendimit nr. 807, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore”; të vendimit nr. 888, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”,

AUTORIZOJ:

1. Znj. Gensila Ilo, drejtor i Drejtorisë së Shitjes së Pronës Publike, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, të kryej detyrat si vijon:

a) Të nënshkruajë të gjithë dokumentacionin që lidhet me procedurat e shitjes së pronës shtetërore që privatizohet, e shoqëruar me vulën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit;

b) Administrimin e procesit të shitjes së pronës publike dhe marrëdhënieve me të tretët;

c) Përgatitjen dhe mbylljen e procesit të shitjes së pronës publike, nënshkrimin e kontratave të shitjes, nënshkrimin për legalizimin e kontratave, autorizimin për dorëzimin e pronës, verifikimin e sipërfaqeve të pronës shtetërore që kërkohet të kalojë në pronë private;

d) Nënshkrimin e korrespondencave me institucionet shtetërore, personat fizikë/juridikë për kërkesat që lidhen me konfirmimin e dokumentacionit dhe dhënien e informacionit për

privatizime të kryera ndër vite nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit, ish-Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, ish-Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike dhe Drejtoria e Shitjes së Pronës Publike.

2. Ky autorizim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË DHE
INOACIONIT

Delina Ibrahimaj

VENDIM**Nr. 12, datë 12.2.2026****NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Genti Ibrahim,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 12.2.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 2 (Gj) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Gjergj Vladi, përfaqësuar nga avokati Ndue Marku, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ministria e Mbrojtjes, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm, Aleks Marku. Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4363 (271), datë 27.6.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 45, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës



Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkesit Gjergj Vladi (*kërkesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesi, me urdhrin nr. 1157, datë 25.5.1982, të ministrit të Mbrojtjes, është titulluar “Oficer aktiv”. Me dekretin nr. 1011, datë 23.1.1995, të Presidentit, ai ka marrë gradën “Gjeneral brigade”. Në vijim, me dekretin nr. 1889, datë 4.9.1997, Presidenti ka vendosur lirimin nga detyra të kërkesit, duke e vendosur në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes. Më pas, me dekretin nr. 2144, datë 22.6.1998, të Presidentit (*dekreti nr. 2144/1998*), kërkesi është ulur në gradë për shkelje të rëndë të disiplinës ushtarake. Pas kësaj, me urdhrin e ministrit të Mbrojtjes nr. 2367/1, datë 24.7.1998, kërkesi është nxjerrë në rezervë, për shkak të pamundësisë së sistemimit në detyrë tjetër, në përputhje me gradën e tij ushtarake. Të drejtat financiare si oficer aktiv i janë ndërprerë në datën 21.6.1998 dhe pas kësaj date ai është trajtuar sipas nenit 10, të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, “Për sigurimin shoqëror, suplementar, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, me të ardhura mujore bruto 29.680 lekë.

2. Kërkesi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt anulimin e dekretit për uljen në gradë. Me vendimin nr. 3142, datë 1.6.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur anulimin pjesërisht të dekretit nr. 2144/1998, në pikën 1, paragrafi 3, të tij, që bënte fjalë për kërkesin. Me vendimin nr. 1436, datë 15.11.2006,

kjo gjykatë ka lëshuar edhe urdhrin e ekzekutimit për vendimin e saj nr. 3142, datë 1.6.2006. Pas ekzekutimit të vendimit, kërkesi është nxjerrë përsëri në rezervë me dekretin nr. 5261, datë 13.4.2007, të Presidentit. Më pas, nga data 13.5.2007, kërkesi është trajtuar me pagesë kalimtare sipas nenit 12, të ligjit nr. 9418, datë 20.5.2005, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në masën 50% të pagës referuese mujore, 32.350 lekë.

3. Në vijim, kërkesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, për t’i paguar shumën që përbëhet nga shpërblimi i pagës, shpërblimi për vjetërsi, shpërblimi për shkak të gradës, si dhe shpërblimi i pagës së bashkëshortes për periudhën e heqjes së gradës nga data 22.6.1998 deri në datën 11.5.2007. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4483, datë 25.5.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ky vendim, mbi ankimin e kërkesit, është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1063, datë 9.6.2010, me të cilin është vendosur pranimi pjesërisht i padisë së kërkesit dhe detyrimi i Ministrisë së Mbrojtjes t’i paguaj atij shpërblimin e pagës për periudhën e heqjes së gradës nga data 22.6.1998 deri në datën 11.5.2007 dhe sigurimet shoqërore, ndërsa kërkimet e tjera në padi janë rrëzuar. Mbi rekursin e subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2211 (258), datë 3.4.2014, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Në datën 5.4.2016, kërkesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe standardin e arsytimit të vendimit (*kërkesa nr.1*). Gjykata, pasi i vlerësoi si të bazuara këto pretendime, me vendimin nr. 82, datë 20.9.2016 (*vendimi nr. 82/2016*), vendosi pranimin e kërkesës, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-2211 (258), datë 3.4.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë.

5. Në zbatim të vendimit të Gjykatës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi rishqyrtoi çështjen në dhomën e këshillimit, me vendimin nr.



00-2022-4518 (447), datë 22.12.2022, ka vendosur sërish prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Në datën 20.4.2023, kërkuksi i është drejtuar përsëri Gjykatës, duke pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës (*kërkesa nr.2*). Gjykata, pasi vlerësoi si të bazuar pretendimin e kërkuksit për cenimin e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të saj, me vendimin nr. 66, datë 6.12.2023 (*vendimi nr. 66/2023*), vendosi pranimin e kërkesës, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2022-4518 (447), datë 22.12.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë.

7. Po në zbatim të vendimit të Gjykatës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka rishqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore publike, me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, me qëllim zhvillimin e praktikës gjyqësore lidhur me të drejtat që rrjedhin nga mbajtja e statusit të ushtarakut aktiv dhe atij në rezervë. Në përfundim, me vendimin nr. 00-2024-4363 (271), datë 27.6.2024, ai kolegji ka vendosur sërish prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Në datën 4.3.2025 kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 6.5.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, ndërsa kjo e fundit, në datën 20.5.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazën e dokumenteve. Në datën 18.12.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarit të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për shkak se kishte marrë pjesë në dhënien e një prej vendimeve të Gjykatës së Lartë në procesin e rishqyrtimit, të përmbyllur me vendimin objekt të ankimit kushtetues.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuksi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

9.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

9.1.1 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, për shkak se:

i. Gjykata e Lartë ka “sakrifikuar” interesat e kërkuksit për të mos pranuar karakterin “*erga omnes*” të vendimeve të Gjykatës. Ajo gjykatë, qëllimisht, ka devijuar krejtësisht nga thelbi i kërimit të vërtetë të kërkuksit në mosmarrëveshjen në shqyrtim, i cili ka qenë pikërisht rivendosja “*ad integrum*” dhe “*ex tunc*” e të gjitha të drejtave të tij të cenuara nga një akt administrativ (dekreti nr. 2144/1998), i konstatuar si absolutisht i pavlefshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë (vendimi nr. 3142, datë 1.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë). Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë nuk kanë konstatuar pavlefshmërinë absolute të urdhrit të ministrit të Mbrojtjes, si një akt i bazuar në dekretin absolutisht të pavlefshëm të Presidentit. Gjykata e Lartë ka detyrimin ligjor të studiojë çështjen në tërësi dhe të zbulojë shkakun ligjor të padisë dhe kërkimet e kërkuksit, si detyrim që rrjedh nga vendimi unifikues nr. 3/2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Ajo gjykatë, pavarësisht se kërkuksi në parashtrimet e tij ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ dhe efekteve të kësaj pavlefshmërie, nuk është shprehur në lidhje me to, përveçse ka vepruar me dy standarde, duke mos respektuar praktikën gjyqësore për raste të ngjashme gjykimi;

ii. Në seancën gjyqësore të datës 2.5.2024, në Gjykatën e Lartë, kërkuksi ka parashtruar, në formën e një kërkesë paraprake, edhe kërkesën për mungesën e legjitimitetit të përfaqësuesit të palës së paditur rekursuese, pasi rekursi, në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, është nënshkruar nga një funksionar mbi bazën e një akti delegimi të pavlefshëm. Urdhri nr. 756, datë 17.5.2007, “Për delegim kompetence” është bërë objekt shqyrtimi edhe më parë nga Kolegji Administrativ, i cili e ka deklaruar atë të pavlefshëm. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk referon asnjë dispozitë ligjore në të cilën mbështet vendimarrjen e saj për rrëzimin e kërkesës së kërkuksit për mungesën e legjitimitetit të



përfaqësuesit të palës së paditur rekursuese në Gjykatën e Lartë;

iii. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që ka anuluar dekretin e Presidentit nr. 2144/1998, ka efekt prapaveprues dhe shtrin pasojat që nga koha e daljes së aktit administrativ, ndryshe nga sa ka vendosur Gjykata e Lartë, e cila ka kufizuar në mënyrë arbitrare efektet e atij vendimi vetëm me kthimin e gradës së ulur me dekretin e Presidentit nr. 2144/1998, ndërkohë që nuk i ka rikthyer kërkuesit të drejtat e parashikuara nga statusi i ushtarakut për periudhën 22.6.1998–11.5.2007. Duke cunguar dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, Gjykata e Lartë, me vendimin e kundërshtuar, pengon ekzekutimin e atij vendimi, në kundërshtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës e drejta e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është pjesë përbërëse e së drejtës për një gjykatë, si edhe e parimit të sigurisë juridike;

iv. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se padia e kërkuesit është parashkuar, pasi është ngritur pas afatit 3-vjeçar të parashkuar nga ligji, ndonëse kërkuesit e drejta e padisë i ka lindur në momentin e nxjerrjes në rezervë me dekretin e Presidentit nr. 5261/2007, kur marrëdhënia juridike e shërbimit publik midis kërkuesit dhe Forcave të Armatosura ka përfunduar *de jure*.

9.1.2 *Parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh vendimin gjyqësor të formës së prerë me të cilin është vendosur anulimi pjesërisht i dekretit të Presidentit për uljen në gradë, ndërsa ka cunguar dispozitivin e atij vendimi dhe duke i dhënë vetes diskrecion të paligjshëm, arsyetimi i saj bie në kundërshtim jo vetëm me nenin 112, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurave Administrative të vitit 1999, por edhe me vetë praktikën e unifikuar gjyqësore (vendimet nr. 5/2009 dhe nr. 5/2012), në të cilat është thënë se një veprim (akt) i pavlefshëm nuk prodhon pasoja dhe për konstatimin e tij nuk ka nevojë të ngrihet padi, por mjafton të konstatohet, madje edhe kryesisht nga gjykata.

9.1.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar lidhur me konkluzionet, konstatimet dhe detyrat e lëna nga Gjykata me vendimin nr. 66/2023, si dhe nuk ka argumentuar lidhur me moszbatimin e vendimit të formës së prerë dhe për pasojat juridike që ai sjell për kërkuesin dhe për palën kundërshtare në proces. Po kështu,

nuk ka referencë për praktikën gjyqësore së cilës i referohet në mbajtjen e qëndrimit të saj, si dhe nuk përcakton dispozitën ligjore ku mbështet “konvalidimin” e rekursit të paligjshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, të nënshkuar nga një autoritet pa tagra ligjore. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje disa prej kërtimeve në kërkesën paraprake dhe në parashtrësën me shkrim, të paraqitura prej kërkuesit në seancën gjyqësore në Gjykatën e Lartë;

9.2. *Të drejtën e pronës*, pasi sipas aktit të ekspertimit të kryer në shkallë të parë, të drejtat financiare të munguara dhe dëmshpërblimi për periudhën 22.6.1998–13.5.2007, si të drejta të fituara me vendim të formës së prerë, arrijnë vlerën 7.251.124 lekë, pa llogaritur kamatëvonesat, sikurse është pranuar edhe nga gjykata e apelit me vendim të formës së prerë. Kjo vlerë përbën pronë sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së. Gjithashtu, jurisprudenca e konsoliduar e gjykatave shqiptare paraqet shumë raste të ngjashme me rastin e kërkuesit, në të cilat gjykatat kanë njohur të drejtat financiare të ish-ushtarakëve të ndodhur në të njëjtat pozita me kërkuesin (vendimet nr. 00-2014-4371 (596), datë 11.11.2014 dhe nr. 00-2012-995, datë 25.4.2012, të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimet nr. 330, datë 25.1.2007, e nr. 1446, datë 28.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

10. *Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

10.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk qëndron, pasi kërkuesi në asnjë moment nuk referon shkelje konkrete të Gjykatës së Lartë, e cila vetëm ka interpretuar ligjin lidhur me provat dhe faktet e administruara nga gjykatat më të ulëta. Pretendimi për mungesën e legjitimitetit të përfaqësuesit të palës së paditur rekursuese, për shkak të delegimit të pavlefshëm, nuk qëndron, pasi gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë është paraqitur përfaqësuesi i kësaj ministrie me autorizimin përkatës, i cili është legjitimuar dhe njohur nga gjykata.

10.2 Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk qëndron, pasi kërkuesi pas daljes në rezervë ka përfutur pagesë kalimtare dhe trajtim me pension të parakohshëm si ushtarak në rezervë, duke mos qenë më ushtarak aktiv për periudhën e pretenduar dhe, për pasojë, nuk mund të pretendojë pagesë për një punë që realisht nuk është kryer. Vendimi nr. 3142, datë 1.6.2006, i Gjykatës së



Rrethit Gjyqësor Tiranë, i referuar nga kërkuesi, ka zgjidhur konfliktin midis tij dhe Presidentit, duke pasur për objekt anulimin e dekretit për ulje në gradë, prandaj nuk ka lidhje me rastin në shqyrtim, kurse vendimi nr. 4483, datë 25.5.2009, i po asaj gjykate ka palë të paditur Ministrinë e Mbrojtjes dhe për objekt pagimin e pagës, vendim ky që është lënë në fuqi me vendimin e kundërshtuar para Gjykatës. Për rrjedhojë, dhënia e dy vendimeve gjyqësore, pavarësisht se lidhen me kërkuesin, nuk krijon pasoja të tilla që e vendosin atë në një situatë të pasigurt nga pikëpamja juridike.

10.3 Pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë, duke u mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), të ndryshuar, ka shqyrtuar pretendimet e palëve dhe ka shprehur qëndrimin e saj edhe për detyrat e lëna nga Gjykata. Vendimi i saj është i rregullt si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Në të trajtohen të gjitha çështjet e ngritura në gjykim dhe Gjykata e Lartë ka dhënë argumente të bazuara në dispozita ligjore për vendimmarrjen e saj. Kërkuesi ka kërkuar pagimin e pagës dhe të të ardhurave të tjera për shkak të punës, duke u bazuar kryesisht në vendimin nr. 3142, datë 1.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur anulimi i dekretit për ulje grade dhe jo kthimi i kërkuesit si ushtarak aktiv, ndërkohë që mbajtja e gradës përkatëse mund të bëhet edhe gjatë kohës që ushtaraku është në rezervë, çka parashikohet nga nenet 7, 10 e vijues të ligjit të kohës nr. 9171/2004, “Për gradat dhe karrierën ushtarake të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”. Dekreti nr. 5261, datë 13.4.2007, i Presidentit ka ndryshuar thjesht statusin e kërkuesit nga ushtarak në rezervë me gradë “Kolonel”, në ushtarak në rezervë me gradë madhore “Gjeneral brigade”, ndërkohë që kërkuesi efektivisht nuk është paraqitur në detyrë, duke mos qenë ushtarak aktiv, për rrjedhojë nuk ka mbajtur asnjë funksion në Forcat e Armatosura për periudhën që pretendon dhe për këtë arsye ai nuk ka përfituar të drejta financiare si ushtarak aktiv. Po kështu, kërkimet e kërkuesit, bazuar në nenet 4 dhe 203 të Kodit të Punës, janë parashkruar.

10.4 Pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës nuk qëndron, pasi vendimi i gjykatës së apelit është ndryshuar nga Gjykata e Lartë me vendimin e

kundërshtuar. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk mund të pretendojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të shfuqizuar nga një gjykatë më e lartë. Referencat e kërkuesit në disa vendime të Gjykatës së Lartë, në të cilat gjykatat kanë njohur të drejtat financiare të ish-ushtarakëve, nuk paraqesin ngjashmëri me rastin e tij, sikurse ai pretendon.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

13. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar procesin gjyqësor që është përmbyllur me vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pas rikthimit të çështjes për rishqyrtim nga kjo Gjykatë me vendimin nr. 66/2023. Në këto rrethana kërkuesi e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për të shteruar për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, përveç kërkesës në këtë Gjykatë.



14. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në çështjen në shqyrtim, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 27.6.2024 dhe sipas korrespondencës së kërkuarit me atë gjykatë, bashkëlidhur ankimit kushtetues, vendimi i është njoftuar përfaqësuesit ligjor të kërkuarit në adresën e tij elektronike në datën 8.11.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 4.3.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuarisi ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe së drejtës së pronës, pretendime të cilat hyjnë në juridiksionin e Gjykatës.

16. Për sa i përket pretendimit për *cenimin e së drejtës së pronës*, sipas nenit 41 të Kushtetutës, Gjykata vëren se argumentet e dhëna nga kërkuarisi lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar, ndaj, për rrjedhojë, çështja do të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

17. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuarit, të ngritura në kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor, Gjykata vëren se ato janë të njëjta, në substancë, me ato të parashtruara në ankimin kushtetues individual të shqyrtuar me vendimin e saj nr. 66/2023 (*shih paragrafin 9, të vendimit nr. 66/2023, të Gjykatës*). Ndonëse kërkuarisi i paraqet ato si cenim të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si edhe të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, këto pretendime, në thelb, kanë të bëjnë me standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me atë të arsytimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, duke qenë se çështja është shqyrtuar përsëri nga Gjykata e Lartë, ato do të trajtohen në drejtim të respektimit, nga kjo e fundit, të këtij standardi.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me atë të arsytimit të vendimit gjyqësor

18. Kërkuarisi ka pretenduar, në thelb, se Gjykata e Lartë, në rishqyrtimin e çështjes pas vendimit nr. 66/2023, të Gjykatës, nuk ka respektuar standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të saj të lidhur ngushtë me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë nuk ka nxjerrë pasojat juridike që rrjedhin nga vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 3142, datë 1.6.2006, me të cilin është anuluar pjesërisht dekreti i Presidentit për uljen e tij në gradë, pasi ka kufizuar efektet e atij vendimi vetëm në rikthimin e gradës, pa pranuar edhe pasojat e tjera juridike e financiare që duhej të rridhnin prej tij. Në këtë kuptim, kërkuarisi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka anashkaluar thelbin e kërtimeve të tij të lidhura me rivendosjen e plotë të të drejtave të cenuara nga akti i konstatuar si i pavlefshëm, nuk ka trajtuar në mënyrë të plotë çështjen e pavlefshmërisë së aktit pasues të nxjerrjes në rezervë, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga praktika të tjera të ngjashme gjyqësore dhe nuk ka dhënë një arsyetim të plotë e bindës për mosmarrjen parasysh të këtyre elementeve. Po kështu, ai ka kundërshtuar edhe mënyrën sesi Gjykata e Lartë ka rrëzuar pretendimin e tij për mungesën e legjitimitetit të përfaqësuesit të palës rekursuese, Ministrisë së Mbrojtjes, duke pretenduar se rekursi ishte ushtruar nga një funksionar pa tagra të vlefshme dhe se vendimi nuk ka dhënë një bazë të mjaftueshme ligjore për arsytimin e kundërt. Sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë ka gabuar edhe për sa i përket vlerësimit për parashkrimin e padisë, pasi e ka lidhur lindjen e së drejtës së padisë me momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare në vitin 1998, ndërkohë që kjo e drejtë, sipas tij, ka lindur vetëm me nxjerrjen e tij në rezervë me dekretin e Presidentit nr. 5261/2007. Këto mangësi, sipas kërkuarit, në drejtim të zbatimit të vendimit të Gjykatës dhe të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, kanë sjellë për pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe për këtë shkak edhe të interesave të tij pasurore.

19. Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes, ka prapësuar, në thelb, se Gjykata e Lartë, në rishqyrtimin e çështjes pas vendimit nr. 66/2023, të Gjykatës, ka respektuar standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me



standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Sipas subjektit të interesuar, Gjykata e Lartë ka shqyrtuar pretendimet e palëve, ka dhënë përgjigje për çështjet e ngritura në gjykim dhe e ka mbështetur vendimarrjen e saj në dispozitat ligjore përkatëse. Në këtë kuptim, sipas subjektit të interesuar, kundërshtimi i kërkuarit për mungesën e legjitimitetit të përfaqësuesit të palës rekursuese nuk qëndron, pasi në seancën gjyqësore para Gjykatës së Lartë ministria është përfaqësuar nga person i autorizuar, i legjitimuar rregullisht nga gjykata. Po kështu, sipas këtij subjekti, Gjykata e Lartë ka arsyetuar drejt edhe për efektet e vendimit gjyqësor nr. 3142, datë 1.6.2006, duke theksuar se ky vendim ka pasur për objekt vetëm anulimin e dekretit për uljen në gradë dhe jo rikthimin e kërkuarit në statusin e ushtarakut aktiv. Për këtë arsye, vijon subjekti i interesuar, kërkuar nuk mund të pretendojë të drejta financiare si ushtarak aktiv për periudhën për të cilën ai nuk ka ushtruar realisht detyrën, aq më tepër kur, pas daljes në rezervë, ai ka përfutur pagesë kalimtare dhe trajtim si ushtarak në rezervë. Në vijim, subjekti i interesuar është shprehur se Gjykata e Lartë ka arsyetuar drejt edhe për çështjen e parashkrimit, pasi kërkimet e kërkuarit, të lidhura me marrëdhënien e posaçme të punësimit dhe me të drejtat pasurore që, sipas tij, rrjedhin prej saj, ishin të parashkruara. Së fundi, sipas subjektit të interesuar, rastet e tjera gjyqësore të referuara prej kërkuarit nuk paraqesin ngjashmëri të tillë me çështjen konkrete për të justifikuar një zgjidhje të ndryshme.

20. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehën qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese dhe autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet edhe tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilëve do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 49, datë 3.7.2017; nr. 15, datë 1.3.2017; nr. 44, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjithashtu, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e

rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, duke u dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të palëve (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2023; nr. 11, datë 24.5.2022; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po ashtu, Gjykata ka pohuar se u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose kur ai është i tillë sa e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 1.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nën dritën e standardeve të mësipërme, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të kërkuarit, si në dy kërkesat e para drejtuar asaj, ashtu edhe në kërkesën objekt shqyrtimi, ka të bëjë me faktin se Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk kanë marrë parasysh dispozitivin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 3142, datë 1.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është vendosur anulimi pjesërisht i dekretit të Presidentit për uljen e gradës, duke anashkaluar pasojat ligjore që sjell ky vendim, dhe se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar me dy standarde dhe nuk ka respektuar praktikën gjyqësore për raste të ngjashme gjykimi, duke dhënë vendime të kundërta. Për rrjedhojë, objekt i shqyrtimit kushtetues në këtë rast nuk është rivlerësimi i mënyrës së interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë si gjykatë e ligjit, por verifikimi nëse ajo në rishqyrtimin e çështjes ka respektuar detyrat e lëna nga kjo Gjykatë dhe ka dhënë një arsyetim që përmbush standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, veçanërisht në drejtim të efekteve të vendimit nr. 3142, datë 1.6.2006, të legjitimitetit të



përfaqësuesit të palës rekursuese dhe të vlerësimit për parashkrimin e padisë.

24. Me vendimin e saj nr. 82/2016, Gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i bazuar, pasi në çështje të tjera, ku pretendimet kanë qenë të njëjta me ato të kërkuarit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme. Në këto kushte ka vend për të mbajtur një qëndrim njësoj nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me zbatimin e ligjit për pretendimet e parashtruara në atë gjykim (*shih paragrafët 19–21 të vendimit nr. 82/2016, të Gjykatës*). Gjithashtu, Gjykata në këtë vendim ka vlerësuar se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit, në kushtet kur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar qëndrimin e tij lidhur me efektet e vendimit të formës së prerë nr. 3142, datë 1.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, megjithëse Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, kishte detyrimin për të argumentuar pasojat që vinin si rrjedhojë e këtij vendimi. Gjykata ka theksuar, në veçanti, se kërkuari nuk ka pretenduar shpërblim page si ushtarak aktiv, por shpërblime që, sipas tij, rridhnin nga grada “Gjeneral brigade”. Për rrjedhojë, në harmoni me parimin e sigurisë juridike, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të ishte i qartë në arsyetimin e vendimit për pasojat që rrjedhin nga vendimi nr. 3142, datë 1.6.2006, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi nga mosrespektimi i tij kërkuarit i janë cenuar të drejta të përfituara me vendim të formës së prerë (*shih paragrafin 28, të vendimit nr. 82/2016 të Gjykatës*).

25. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka rishqyrtuar çështjen dhe me vendimin e tij të dytë, për sa i përket nevojës për njësimin e praktikës gjyqësore, ka vlerësuar se Gjykata u është referuar ligjeve të kohës kur është gjykuar për herë të parë kjo çështje, sipas të cilave kryetari i Gjykatës së Lartë, secili nga kolegjet ose Kolegjet e Bashkuara mund të kërkonin që kjo gjykatë të shprehej në Kolegje të Bashkuara për kurse të paraqitura nga palët, për të cilat kishte praktika të ndryshme të mëparshme në kolegje të thjeshta. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ ka arritur në përfundimin se detyra e lënë nga Gjykata për Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk mund të realizohej më për shkak të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 dhe të ndryshimeve vijuese që pësoi ligji nr. 49/2012 (me ligjin nr. 39/2017), të cilat forcuan më tepër rolin e

Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili njëson praktikën me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë dhe siguron/zhvillon praktikën gjyqësore me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, ndërsa Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë më rol parësor në njësimin e praktikës gjyqësore. Kolegji i zakonshëm e dërgon një çështje për njësim pranë kolegjit me pesë gjyqtarë vetëm kur, nëpërmjet zhvillimit të praktikës gjyqësore, nuk mund të ndreqet shkelja e rëndësishme e ligjit material e kryer prej gjykatave më të ulëta. Pra, jo çdo vendimmarrje që nuk është e njëjtë mund të justifikojë automatikisht kalimin për njësim. Në përfundim, Kolegji Administrativ ka argumentuar se ka mundësi ta ndreqë vetë praktikën gjyqësore sporadike, e cila nuk përputhet me linjën e përgjithshme të praktikës gjyqësore të Kolegjit, duke konsoliduar një qëndrim të mbajtur në vijimësi. Rrjedhimisht, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se problematika e paraqitur për gjykim, si dhe praktikën e kundërta të gjetura nga Gjykata, nuk janë të një sasive, kohe dhe natyre të tillë që të justifikojnë zhvillimin e një procedure njësoje. Por, nga ana tjetër, në respekt të vendimit të Gjykatës, ka vend që, në zbatim të kompetencave të saktësuara të Kolegjit Administrativ, të zhvillohet praktika gjyqësore, duke u saktësuar dhe arsyetuar zbatimi korrekt i ligjit për rastin konkret, gjithnjë referuar shkaqeve të rekursit që parashikon ligji i kohës kur rekursi është paraqitur (*shih paragrafët 17–18, të vendimit nr. 00-2022-4518 (447), datë 22.12.2022, të Gjykatës së Lartë*).

26. Ndërkohë, në vijim të ankimit kushtetues të dytë, me vendimin e saj nr. 66/2023, Gjykata ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të saj (Gjykatës) të lidhur me atë të arsytimit të vendimit, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, për t'i dhënë zgjidhje çështjes së kërkuarit, edhe pse nuk mund ta kalonte çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të saj, të cilat nuk kanë më kompetencë për njësimin e praktikës gjyqësore, ishte i detyruar të zbatonte vendimin e Gjykatës, duke ia kaluar çështjen për shqyrtim trupës me pesë gjyqtarë, si organi që, sipas parashikimeve të reja ligjore, ka kompetencë për njësimin e praktikës gjyqësore (*shih paragrafin 33, të vendimit nr. 66/2023, të Gjykatës*). Gjithashtu, Gjykata, në këtë vendim, ka vlerësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka përmbushur detyrat e përcaktuara në vendimin e saj nr. 82/2016, për sa kohë e ka



vlerësuar çështjen e kërkuarit vetëm në drejtim të zhvillimit të praktikës, pra të zbatimit dhe interpretimit të ligjit, duke e trajtuar si një rekurs të paraqitur për herë të parë dhe duke e shndërruar detyrën e lënë nga Gjykata në një çështje juridike që i përkiste vetëm vlerësimit diskrecional të tij (*shih paragrafin 34, të vendimit nr. 66/2023, të Gjykatës*).

27. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në rastin e tretë, që përbën edhe objektin e ankimit kushtetues individual të kërkuarit, fillimisht, ka konfirmuar qëndrimin e tij të konsoliduar se vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme për autoritetet publike, përfshirë gjykatat e zakonshme, sikurse edhe për Gjykatën e Lartë. Në këtë kuadër, Kolegji Administrativ ka evidentuar se krijohet një lloj “tensioni” në rastet kur Gjykata “detyron” Gjykatën e Lartë të ushtrojë kompetencën e saj organike dhe ekskluzive, atë të njësitit të praktikës gjyqësore, sikurse edhe në rastin konkret, veçantia e të cilit, sipas atij kolegji, është se Gjykata e Lartë, pavarësisht se ka arsyetuar shkaqet për të cilat ka vlerësuar se njësimi i praktikës gjyqësore e kishte humbur qëllimin, Gjykata në vendimin nr. 66/2023, në thelb, ka arsyetuar se Kolegji Administrativ nuk ka pasur hapësirë vlerësimi për të zbatuar detyrën për njësimin e praktikës gjyqësore, dhe se, duke vepruar në këtë mënyrë, me vendimin e kundërshtuar Kolegji Administrativ kishte cenuar besimin e kërkuarit tek sistemi juridik, tek shteti, tek institucionet dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih paragrafin 38 të vendimit nr. 00-2024-4363 (271), datë 27.6.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

28. Në vijim, lidhur me nevojën për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar, në thelb, se njësimi dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore përbëjnë funksionin e saj kryesor kushtetues dhe kompetencë ekskluzive, në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës dhe të parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar. Sipas Kolegjit Administrativ, pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, kompetenca për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore ushtrohet nga kolegjet me pesë gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, ndërsa nisja e një procedure njësuere justifikohet vetëm kur evidentohej qëndrime të ndryshme dhe të qëndrueshme mbi të njëjtën çështje juridike, kur paqartësia në zbatimin e ligjit nuk është stabilizuar me kalimin e kohës dhe kur çështja paraqet aktualitet, në kuptimin që i përgjigjet nevojës për zgjidhjen e një numri të pacaktuar ose të

papërcaktueshëm rastesh. Në këtë këndvështrim, Kolegji Administrativ ka theksuar se një vendim njësuere nuk mund t’u shërbejë nevojave të një rasti individual ose të izoluar, ndërsa zhvillimi i praktikës gjyqësore përbën instrumentin përmes të cilit mund të elaborohen më tej standarde jurisprudenciale edhe në mungesë të kushteve të plota për njësim. Në vijim, ai kolegji ka mbajtur qëndrimin se vlerësimi i plotësimit ose jo të kushteve për njësimin e praktikës gjyqësore mbetet në kompetencën ekskluzive të Gjykatës së Lartë, ndërsa Gjykata mund të konstatojë cenim të sigurisë juridike nga mosnjësimi i praktikës dhe të orientojë nevojën për njëtrajtësim, por jo të zëvendësojë vlerësimin e saj për zgjedhjen e mjetit konkret juridik. Mbi këtë bazë, Kolegji Administrativ ka çmuar se rasti konkret nuk paraqet kushtet për njësim, pasi ka natyrë tejet të posaçme, se praktika e ndryshme e evidentuar i përket një periudhe të mëparshme dhe se çështja nuk paraqet më aktualitet për qëllime njësimi, për shkak të ndryshimeve të njëpasnjëshme të kuadrit ligjor dhe mungesës së një numri të konsiderueshëm çështjesh të ngjashme në gjykim. Për rrjedhojë, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se ndodhej në kushtet e zhvillimit të praktikës gjyqësore dhe jo të njësitit të saj, duke e kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore publike me trup gjykues prej pesë gjyqtarësh dhe duke shtruar për zgjidhje çështjen nëse ushtaraku i dalë në rezervë, i cili nuk ka kundërshtuar gjyqësisht urdhrin e ministrit të Mbrojtjes për daljen në rezervë, por vetëm dekretin e Presidentit për uljen në gradë, ka të drejtë të përfitojë shpërblim financiar si ushtarak aktiv (*shih paragrafët 39–57, të vendimit nr. 00-2024-4363 (271), datë 27.6.202, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

29. Ndërkohë, në lidhje me çështjen e shtruar për zhvillimin e praktikës gjyqësore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pas hulumtimit të praktikës gjyqësore për rastet e ushtarakëve aktivë të ulur në gradë dhe të nxjerrë më pas në rezervë/lirim, si dhe pas analizës së legjislacionit të posaçëm për gradat dhe statusin e ushtarakut, ka arritur, në thelb, në përfundimin se dalja në rezervë nuk barazohet me humbjen e gradës, se ushtaraku në rezervë mbetet subjekt i dallueshëm nga ushtaraku aktiv, por vijon të ruajë gradën që ka pasur në çastin e daljes në rezervë, dhe se efektet e kësaj grade gjatë periudhës kur ushtaraku është në rezervë janë, në thelb, honorifike dhe funksionale për rastet e rikthimit në



shërbim ose të thirrjes në stërvitje. Në këtë kuptim, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se legjislacioni përkatës nuk njeh të drejtë page për ushtarakun në rezervë vetëm për shkak të mbajtjes së gradës, ndërsa të drejtat financiare lidhen me ushtrimin efektiv të detyrës ose me rastet kur ai thirret në shërbim ose stërvitje. Po kështu, Kolegji Administrativ ka theksuar se për mosmarrëveshjet që lidhen me nxjerrjen në rezervë, legjislacioni përkatës ka parashikuar mjete dhe afate të posaçme kundërshtimi. Mbi këtë bazë, ai ka arritur në përfundimin se ruajtja ose ndryshimi i gradës gjatë kohës së rezervës nuk sjell, në vetvete, lindjen e një të drejte page për periudhën e qëndrimit në rezervë (*shih paragrafët 58–86, të vendimit nr. 00-2024-4363 (271), datë 27.6.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

30. Mbi këtë bazë, në lidhje me zgjidhjen e çështjes së kërkesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi i palës së paditur (subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes) përmbante shkaqe të bazuara për cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Në këtë kuptim, ai ka çmuar, së pari, se pretendimi i kërkesit për pavlefshmërinë e rekursit, me argumentin se ai ishte nënshkruar nga zëvendësministri i Mbrojtjes, jashtë tagrave të deleguara, ishte i pambështetur në ligj, pasi në gjykimin e parë të çështjes në Gjykatën e Lartë pala e paditur ishte përfaqësuar nga një përfaqësues me autorizim të posaçëm, të vlefshëm për të gjitha shkallët e gjykimit, i cili u kishte qëndruar shkaqeve të rekursit. Për më tepër, mbi bazën e këtij rekursi, Gjykata e Lartë ishte investuar dy herë për shqyrtimin e çështjes në themel dhe vendimet e saj i ishin nënshtruar edhe kontrollit të Gjykatës. Për rrjedhojë, edhe nëse do të pranohej ekzistenca e një parregullsie fillestare në ushtrimin e rekursit, ajo ishte konvaliduar nga miratimi i hapur i palës së paditur në seancë gjyqësore, në kuptim të nenit 78 të Kodit Civil (KC). Së dyti, Kolegji ka vlerësuar se fuqia detyruese e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 3142, datë 1.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhej vetëm me rikthimin e gradës së ulur kërkesit me dekretin e Presidentit nr. 2144/1998, por jo edhe me rikthimin e tij në statusin e ushtarakut aktiv ose me lindjen, për këtë shkak, të së drejtës për përfitime financiare si i tillë. Së treti, ai ka çmuar se kërkimet e paditësit (kërkesit), ndonëse të mbështetura në pasojat e pavlefshmërisë së

dekretit për uljen në gradë, në thelb rridhnin nga marrëdhënia e posaçme e punësimit dhe nga pretendimi për shpërblim dëmi me natyrë pasurore. Për këtë arsye, Kolegji ka vlerësuar se padia ishte e parashkruar, duke iu referuar nenit 115, shkronja “dh”, të KC-së, sipas të cilit paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor parashkruhen brenda 3 vjetëve, nenit 203 të Kodit të Punës, që parashikon afatin 3-vjeçar të parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit dhe anasjelltas, si edhe nenit 112 të KC-së, sipas të cilit e drejta e padisë që nuk ushtrohet brenda afatit ligjor shuhet dhe nuk mund të realizohet me anë të gjykatës. Në këtë drejtim, Kolegji Administrativ ka arritur në përfundimin se momenti i lindjes të së drejtës së padisë ishte ai i shkëputjes së marrëdhënieve financiare të rregullta të kërkesit me palën e paditur, pra viti 1998, ndërkohë që padia ishte ngritur vetëm në vitin 2010. Për rrjedhojë, ai ka konkluduar se kishte vend për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*shih paragrafët 27, 87–94, të vendimit nr. 00-2024-4363 (271), datë 27.6.2024, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

31. Në analizë të sa më sipër, Gjykata çmon se në vendimet e saj të mëparshme, kur ka evidentuar nevojën për ndërhyrjen e Gjykatës së Lartë në funksion të njëtrajtshmërisë dhe koherencës së praktikës gjyqësore, ajo nuk ka pasur si qëllim thjesht nxjerrjen e një vendimi njëses në kuptimin formal të fjalës, por garantimin e standardit të sigurisë juridike përmes një qasjeje të njëtrajtshme dhe të arsyetuar për çështjen juridike të ngritur, në mënyrë që të shmangeshin qëndrimet e kundërta në jurisprudencë dhe të sigurohej parashikueshmëria e zbatimit të ligjit. Në këto rrethana, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë e ka përmbushur këtë detyrë, së pari, në aspektin procedural, duke ia kaluar çështjen për shqyrtim trupës me pesë gjyqtarë, si organi që sipas parashikimeve të reja kushtetuese dhe ligjore ushtron funksionin e njësimi ose të zhvillimit të praktikës gjyqësore, dhe, së dyti, në aspektin substancial, duke dhënë një arsyetim të zgjeruar për arsyet pse rasti konkret nuk paraqiste kushtet për njësimin e praktikës gjyqësore, por për zhvillimin e saj, si dhe duke mbajtur qëndrim të shprehur për çështjet thelbësore të ngritura në gjykim, në ushtrim të kompetencës sipas nenit 141 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mënyra e veprimit të Gjykatës së Lartë ka përmbushur, jo vetëm



formalisht, por edhe në substancë, qëllimin e detyrës së lënë nga kjo Gjykatë. Në këtë kuadër, Gjykata rithekson se vlerësimi i saj nuk shtrihet në zëvendësimin e interpretimit që Gjykata e Lartë i ka bërë ligjit të zakonshëm, por kufizohet në verifikimin nëse kjo e fundit ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata, duke dhënë një arsyetim të mjaftueshëm në aspektin kushtetues.

32. Në vijim, Gjykata çmon se, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë ka kontrolluar mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulëta dhe mbi këtë bazë ka arritur në përfundimin për prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjithashtu, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuarit për mungesën e tagrave të përfaqësuesit të palës së paditur rekursuese, subjektit të interesuar Ministrisë së Mbrojtjes, duke arsyetuar se kjo e fundit ishte përfaqësuar në gjykim nga një person i autorizuar dhe se, edhe nëse do të pranohej ekzistenca e një parregullsie fillestare në ushtrimin e rekursit, ajo ishte konvaliduar, nga miratimi i mëvonshëm i palës së paditur në seancë gjyqësore. Po ashtu, në përmbushje të detyrës së lënë nga Gjykata për arsyetimin e efekteve të vendimit gjyqësor të formës së prerë, me të cilin ishte anuluar dekreti për uljen në gradë të kërkuarit, Gjykata e Lartë ka argumentuar se anulimi i atij dekreti nuk ka sjellë si pasojë edhe shfuqizimin e urdhrit të ministrit të Mbrojtjes për daljen e kërkuarit në rezervë, pra nuk ka sjellë kthimin e tij në statusin e ushtarakut aktiv. Gjithashtu, ajo ka arsyetuar se padia e kërkuarit ishte e parashkruar, duke iu referuar neneve 112 dhe 115, shkronja “dh”, të KC-së, si dhe nenit 203 të Kodit të Punës. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkuarit, si për efektin juridik të vendimit gjyqësor të formës së prerë, ashtu edhe për përfaqësimin e palës rekursuese dhe çështjen e parashkrimit. Në këto kushte dhe pa u vendosur në rolin e një shkalle të katërt gjykimi për të rivlerësuar mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi i kësaj të fundit nuk paraqet mangësi të tilla në arsyetim që të vënë në dyshim pajtueshmërinë e tij me standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

33. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të

zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me atë të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

34. Nga ana tjetër, pa cenuar përfundimin e mësipërm për themelin e kërkesës, Gjykata çmon të theksojë se sipas jurisprudencës së saj parimi i luajalitetit kushtetues kërkon që organet kushtetuese të sillen në mënyrë koherente dhe jo kontradiktore, të shmangin qëndrimet e paqarta ose të pajustificuara dhe të bashkëveprojnë mbi baza mirëbesimi e korrekte, në respekt të kompetencave të secilit (*shih vendimin nr. 26, datë 25.5.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, ndonëse Gjykata e Lartë mund të shprehë konsiderata për kuptimin dhe ushtrimin e kompetencave të saj kushtetuese në funksion të njësimi ose zhvillimit të praktikës gjyqësore, disa formulime të përdorura në arsyetimin e vendimit të saj, objekt i kontrollit kushtetues, për nga mënyra e të shprehurit, nuk janë plotësisht në përputhje me këtë kërkesë kushtetuese. Në veçanti, referimet që mund të kuptohen si vlerësime në adresë të rolit kushtetues të kësaj Gjykate ose si vënie në diskutim, në plan parimor, të forcës detyruese të vendimeve të saj nuk janë në përputhje me frymën e dialogut institucional dhe mund të dëmtojnë koherencën e rendit kushtetues. Gjykata rithekson se debati mbi kufijtë e juridiksioneve është i lejueshëm për sa kohë zhvillohet në nivelin e argumenteve teknike, por ai duhet të zhvillohet me guhë të matur dhe në frymën e korrektesës së ndërsjellë institucionale, duke respektuar kompetencat kushtetuese të secilit organ dhe në atë mënyrë që të mos bëhet shkas për luhatje të besimit publik, aq i rëndësishëm në shtetin e së drejtës.

35. Në përfundim, Gjykata çmon se, mbështetur në arsyetimin e mësipërm të këtij vendimi, kërkesa është e pabazuar dhe, për rrjedhojë, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,



VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi
ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 12.2.2026.

Shpallur më 9.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja,
Genti Ibrahim, Sandër Beci, Ilir Toska, Marjana
Semini

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

